



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar / Primeshja / Prototato / Received / Delivery	18.04.2023	3	viti / god / year
Organ /Bjësia / Organ /Jedinitca / Org. Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot No	Shënjeja / Protog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMBHTOK	3666/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.445/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.445/2023 të datës 02.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.445/2023 e datës 02.03.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. *Mbetet në fuqi* masa disiplinore “Vërejte” e shqiptuar ndaj ankuesit nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes shkresës me numër ref:24/2023 të datës 01.02.2023.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 02.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shqiptimit të masës disiplinore “Vërejte” nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes shkresës me numër Ref:24/2023 të datës 01.02.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.03.2023 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (*me tej MPJD*) ndërsa kjo e fundit më datë 17.03.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me këtë çështje administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.03.2023 me numër protokolli 2239/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Ref: 24/2023 të datës 01.02.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Planin Individual vjetor të punës për vitin 2023 i përgatitur nga ankuesi të datës 30.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 1542/2023 e datës 09.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2764/2023 e datës 17.03.2023; Akt Emërimi AE.Nr.132/2022 i datës 07.07.2022; Vendimit me Nr. Ref: 311/2022 të datës 16.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimit me Nr.Ref: 287/2023 të datës 02.09.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimit me Nr. Ref:13/2023 të datës 23.01.2023 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Amerikë; E-mailin e datës 31.01.2023, 30.01.2023 nga Zyra e Sekretarit në MPJD për ankuesin; E-mailin e datës 30.01.2023, 31.01.2023 nga ankuesi për Zyrën e Sekretarit në MPJD.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, rrjedhimisht i njëjti sipas Akt-it të Emërimit AE.Nr.132/2022 të datës 07.07.2022 ushtron pozitën e punës *Drejtor i Departamentit për Amerikë.*

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 01.02.2023 përmes shkresës më numër Ref:24/2023, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "*Vërejtje*", me arsyetimin së ankuesi vazhdon të veproj në kundërshtim me Rregulloren (ZKM) Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke mos dërguar planin individual të punës për departamentin që ai drejton edhe përkundër faktit se të njëjtit i është dhënë afati që të dorëzoj planin në fjalë dhe së ankuesi kishte përcjell një dokument plan të punës duke mos njohur autoritetit e Sekretarit të Përgjithshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që masa disiplinore e kundërshtuar më ankesë është shqiptuar nga personi i paautorizuar sepse është nuk posedon fuqinë e autoritetit më të lartë administrativ.

Nisur nga fakti i pa kontestueshëm së ankuesi sipas Akt Emërimit AE.Nr.132/2022 të datës 07.07.2022 mban pozitën *Drejtor i Departamentit për Amerikë*, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji ka analizuar nenin 11 paragrafi 3 të Rregullores (ZKM) Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të

Jashtme dhe Diasporës, me të cilin është përcaktuar se: *3. Drejtori i Departamentit për Amerikë raporton te Sekretari i Përgjithshëm....*" andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor e në mbështetje të dispozitave të nenit 19 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi në cilësi të Drejtorit të Departamenti për Amerika, lidhur me punët dhe veprimtarinë e Departamentit i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të departamentit përfshirë edhe objektivat e divizioneve përbërëse, monitorimin e veprimtarisë së tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre.

Kolegji i Këshilli për vendosje të drejt dhe të ligjshme lidhur me këtë çështje administrative, mori parasysh edhe dispozitat e nenit 18 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, të cilat shprehimisht parashohin se: *Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror. 2. Sekretari i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e ministrit. 3. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore: 3.1. mbështet ministrin në punën e tij; 3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse; 3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit; 3.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror; 3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura; 3.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi; 3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm në këtë rast i MPJD-së është autoriteti më i lartë ekzekutiv/administrativ i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale, kështu që në vlerësimin e Kolegjit është i pabazuar pretendimi ankimor i ankuesit së nënshkruesi i aktit të kundërshtuar me ankesë nuk posedon fuqinë ligjore ekzekutive të autoritetit me të lart administrativ.*

Nisur nga baza ligjore si me lart, Kolegji i Këshillit ka analizuar shkresat e lëndës nga dhe ka konstatuar së ankuesi në mënyrë të vazhdueshme refuzon të njohë autoritetin e Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, në atë mënyrë që i njëjti në komunikimet e tij zyrtare me Sekretarin e Përgjithshëm aplikon shënimin "N/A (nuk është e aplikueshme)", siç është rasti me përgatitjen e Planit Individual të Punës për Departamentin për Amerika ku ankuesi të rubrika e mbikëqyrësit nuk kishte vendosur emrin dhe mbiemrin e Sekretarit të Përgjithshëm si mbikëqyrës i tij por i njëjti vendos shkrimin "N/A (nuk është e aplikueshme)". Po ashtu bazuar në provat materiale të kësaj çështje Kolegji ka konstatuar së ankuesi në mënyrë të vazhdueshme refuzon pjesëmarrjen në takimet zyrtare të thirrura nga Sekretari i Përgjithshëm, ku si pasojë e këtyre veprimeve ankuesit i janë shqiptuar edhe masa tjera disiplinore paraprake dhe atë sipas shkresës më numër Ref: 287/2022 të datës 02.09.2022 dhe shkresës Nr.Ref: 311/2022 të datës 16.09.2022 të shqiptuara nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, kështu që mbi bazën e këtyre rrethanave Kolegji vlerëson së veprimet e ankuesit bien ndesh më nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit.

Bazuar në konstatimet si sipër, Kolegji vlerëson së Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" e kontestuar më ankesë, ka vlerësuar në mënyrë të drejtë përgjegjësinë disiplinore të ankuesit si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke vepruar në pajtim me nenin 45 dhe nenin 50 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Referuar si me lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.445/2023

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPJD; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.